



Institucioni i Avokatit të Popullit	Institucioni i Avokatit të Popullit
Nr./Br./No.	1214/2019
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg.	30/09/19
Data/Datum/Date:	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Opinion

i

Avokatit të Popullit

në lidhje me

sigurimin e qasjes në informim për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar të dëgjimit, në kuadër të debateve televizive për zgjedhjet nacionale të vitit 2019

Drejtuar:

- Z. Muja Ferati, kryetar i Komisionit të Pavarur për Media
- Të gjitha kanaleve televizive në Kosovë

Kopje:

- Z. Habit Hajredini, drejtor, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 30 shtator 2019

QËLLIMI

1. Duke marrë parasysh se në emisionet e deritanishme në kanalet e ndryshme televizive në Kosovë, në rastin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk është vërejtur të jenë angazhuar interpretë të certifikuar në *Gjuhën e Shenjave*¹, si gjuhë amtare e personave të shurdhër, me qëllim që edhe kjo kategori, që përdorin këtë gjuhë, të informohen rrëth programeve politike, me qëllim të vlerësimit të ofertës më të mirë politike për votim të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit paraqet këtë Opinion.

BAZA LIGJORE

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 135 (3): “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”

3. Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nen 18 (1.2): “*Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë.*”; dhe nen 18 (1.6): “*T'i publikojë njofitim, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*”

4. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nen 9 (2.7): “*Ofron këshilla, udhëzime dhe mbështetje, subjekteve të sektorit publik dhe privat mbi praktikat e mira në promovimin e barazisë, në përshtatjen ndaj diversitetit dhe parandalimin e diskriminimit mbi bazat e mbuluara nga Ligji përkatës për Barazi Gjinore dhe nga ky Ligj, si dhe jep rekomandime përmarrjen e masave për promovimin e barazisë, përshtatjen ndaj diversitetit dhe/ose luftimin e diskriminimit.*”

GJENDJA FAKTIKE

5. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 26 shtator 2019, ka hapur rast sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) për Komisionin e Pavarur për Media (më tej: *KPM*) dhe për të gjitha kanalet televizive përkitazi me mosangazhimin e interpretëve të certifikuar të *Gjuhës së Shenjave*, si gjuhë amtare e personave të shurdhër, në kanalet televizive në të cilat prezantohen kandidatët për deputetë të ardhshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Avokati i Popullit me vëmendje i ka ndjekur zhvillimet e fundit të veprimeve parazgjedhore nga ana e kandidatëve për deputetë të ardhshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjet e jashtëzakonshme të këtij viti. Së këndejmi, nga informatat dhe monitorimi i debateve televizive, deri më tani nuk është vërejtur të jenë angazhuar nga kanalet televizive interpretë të certifikuar të *Gjuhës së Shenjave*.

KORNIZA LIGJORE

7. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, paragrafi 2, përcakton: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në*

¹ Sipas Rregullores (QRK) nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në *Gjuhën e Shenjave* në Republikën e Kosovës, nen 3, par. 1.7, “*Gjuha e shenjave*” – nënkuption *Gjuhën e shenjave* e cila ka rregullat e saj gramatikore, strukturën e fjalisë dhe nuancat kulturore.

këtë Kushtetutë.”; par. 3: “Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritet themelore të të tjerve.”

8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, përcakton: “Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gjzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhje kombëtare a shoqërore, lidhje me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”

9. Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”

10. Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo statusi tjetër.”

11. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 2, definon termin “**Gjuhë**”, që përfshin: “*Gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave si dhe forma të tjera të gjuhës jo-të folur.*” Gjithashtu, po në këtë nen definohet termi: “**Diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar**”, që do të thotë çfarëdo dallimi, përjashtimi ose kufizimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar që ka për qëllim ose që ndikon në dëmtimin ose anulimin e njohjes, të gëzimit ose të ushtrimit, në mënyrë të barabartë me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në cilëndo fushë tjetër.

12. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), neni 1, paragrafi 1, përcakton: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimi në bazë të kombësisë apo lidhje me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fëtar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”

13. Neni 3, paragrafi 1, i LMD-së përcakton: “Parimi i trajtimit të pabarabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtëpërdrejtë apo të têrthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.” Ndërsa sipas paragrafit 2, shprehimisht thuhet: “Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlejtësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.”

14. Gjithashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 18, par. 1, përcakton se Avokati i Popullit, mes tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:

- “Të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre.” (Pika 1).
- “Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë.” (Pika 2).
- “Të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave.” (Pika 4).
- “Të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.” (Pika 5).
- “T'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (Pika 6).
- “Të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryej hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.” (Pika 8).

15. Ligji nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në nenin 1, përcakton qëllimin e ligjit në fjalë: “Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejmë: KPM) me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audiovizuele që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.”

16. Neni 3, par. 1, i këtij ligji përcakton: “KPM-ja është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuele.”

17. Neni 34 i këtij ligji përcakton: “KPM-ja do të inkurajojë ofruesit e shërbimeve audiovizuale që të sigurojnë që shërbimet e tyre në mënyrë graduale bëhen të qasshme për njerëzit apo **personat me paftësi dëgjimi** dhe të të pamurit.”

18. Më 29 shtator 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës mori Vendimin nr. 06/146, përmes të cilit zyrtarizoi Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës.²

19. Rregullorja (QRK) nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës, në nenin 1, përcakton: “Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës si dhe qasje në shërbimet e interpretimit, nëpërmjet Interpretëve të Gjuhës së Shenjave për Personat e Shurdhër në Republikën e Kosovës.”

20. Neni 2, par. 1, i kësaj rregullore përcakton: “Kjo rregullore zbatohet për të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe atë lokal.” Kurse par. 2

²Shih Vendimin nr. 06/146 për zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave, i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i datës 29 shtator 2010:

http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_146-te_te_Qeverise_2010.pdf

përcakton: “*Të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe atë lokal, janë të obliguara që personave nga komuniteti i të shurdhërve t’i ofrojnë shërbim sipas nevojës dhe kërkesave në gjuhën e shenjave.*”

ANALIZA LIGJORE

21. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbrojnë dëshirat e drejtave të lirive të themelore të njeriut. Prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve që t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut.

22. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 24, përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhje kombëtare a shoqërore, lidhje me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë, përfshirë KPM-në dhe të gjitha televizionet në Kosovë, në lidhje me rastin konkret.

23. Në kuptim të dispozitës së nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se Konventa përcakton se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tillë si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

24. Sikurse Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, edhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e ndalon diskriminimin. Në nenin 2 të kësaj Konvente definohet termi: “*Diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar*”, i cili nënkupton çfarëdo dallimi, përjashtimi ose kufizimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar që ka për qëllim ose që ndikon në dëmtimin ose anulimin e njohjes, të gëzimit ose të ushtrimit, në mënyrë të barabartë me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në cilëndo fushë tjetër.

25. Ashtu siç u theksua edhe më herët, Avokati i Popullit me vëmendje i ka ndjekur zhvillimet e fundit të veprimeve parazgjedhore nga ana e kandidatëve për deputetë të ardhshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjet e jashtëzakonshme të këtij viti. Së këndejmi, nga informatat dhe monitorimi i debateve televizive, në të cilat flitet për kandidatët për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, së paku deri më tanë, nuk është vërejtur të jenë angazhuar interpretë të certifikuar në *Gjuhën e Shenjave*, si gjuhë amtare e personave të shurdhër, me qëllim që edhe kjo kategori, që përdorin këtë gjuhë, të informohen rrëth programeve politike, me qëllim të vlerësimit të ofertës më të mirë politike për votim të këtyre kandidatëve. Mosdhënia e mundësisë në të kuptuarit të kësaj gjuhe për këtë kategori të personave me aftësi të kufizuar vlerësohet si diskriminim mbi bazë të aftësisë së kufizuar. Ky konstatim i Avokatit të Popullit gjen bazën ligjore edhe në Ligjin nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili është në fuqi dhe që po ashtu ndalon diskriminimin, sikurse në rastin konkret.

26. Ligji nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave bën përcaktimin e kompetencave të KPM-së, me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audiovizuele që u shërben të **gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës**. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë, të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuele. Në këtë kuptim, bazuar në gjendjen e deritanishme të mosangazhimit të interpretëve të certifikuar për Gjuhën e Shenjave, si gjuhë amtare e personave të shurdhër, nga kanalet televizive për zgjedhjet e vitit 2019, në të cilat jepen informacione për kandidatët për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, KPM-ja do të duhej t'i inkurajonte ofruesit e shërbimeve audiovizuale që shërbimet e tyre të janë të qasshme edhe për personat e shurdhër në Kosovë. Saktësisht, ky obligim i tillë ligjor është përcaktuar për KPM-në edhe në nenin 34 të ligjit në fuqi për këtë institucion, ku përcaktohet se KPM-ja do t'i inkurajojë ofruesit e shërbimeve audiovizuale që të sigurojnë se shërbimet e tyre në mënyrë graduale bëhen të qasshme për njerëzit apo për personat me paaftësi dëgimi dhe të të pamurit.

27. Ndër të tjera, më 29 shtator 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës mori Vendimin nr.06/146, përmes të të cilit zyrtarizoi Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës. Prandaj, Avokati i Popullit vlerëson se përdorimi i Gjuhës së Shenjave në vendin tonë është e karakterit obligues për të gjithë dhe, në këtë aspekt, kjo gjuhë ka mbështetje të mjaftueshme ligjore për zbatimin e saj në praktikë, gjë që së paku deri më tanë nuk është zbatuar sikurse në rastin konkret.

28. Për më tepër, Rregullorja (QRK) nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës si dhe qasje në shërbimet e interpretimit nëpërmjet interpretëve të Gjuhës së Shenjave për personat e shurdhër në Republikën e Kosovës. Si e tillë, kjo rregullore zbatohet për të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe në atë lokal, kurse në të përcaktohet se të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe në atë lokal, janë të obliguara që personave nga komuniteti i të shurdhërvë t'i ofrojnë shërbim në gjuhën e Shenjave sipas nevojës dhe kërkësave. Ndonëse rregullorja në fjalë ka karakter obligues vetëm për institucionet publike, megjithatë, në konceptin më të gjerë, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në nenin 2, definon termin "**Gjuhë**", që përfshin: "*Gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave si dhe forma të tjera të gjuhës jo-të folur.*" Pra, si e tillë, kjo konventë e njeh Gjuhën e Shenjave si gjuhë e njëjtë sikurse është gjuha e folur. Për më tepër, ashtu siç u përmend më lart, Kosova që nga viti 2010 e ka zyrtarizuar Gjuhën e Shenjave, pra e njeh atë si gjuhë. Prandaj, në këtë kuptim, fakti që rregullorja në fjalë krijon obligime ligjore vetëm për institucionet publike, megjithatë edhe personat e shurdhër e kanë të drejtën e tyre të votës, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se kanalet televizive duhet të krijojnë praktika të zbatimit dhe të përdorimit edhe në Gjuhën e Shenjave, si mundësi e informimit të drejtë dhe të saktë për këtë kategori të shoqërisë në vendin tonë.

Bazuar në analizën e mësipërme, Avokati i Popullit, në përputhje me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 18 (paragrafi 1.6) të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe nga vlerësimi i gjendjes faktike, nxjerr këtë:

OPINION

Avokati i Popullit, në bazë të vlerësimeve dhe faktave të mbledhura, bazuar në kornizën ligjore në fuqi, si dhe në përputhje me kompetencat që burojnë nga Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmes këtij opinioni paraqet udhëzimet në vijim, me qëllim të *promovimit të barazisë, në përshtatjen ndaj diversitetit dhe parandalimin e diskriminimit mbi bazën e aftësisë së kufizuar në të dëgjuar*:

1. Avokati i Popullit vlerëson se, ndër të tjera, mediat televizive kanë për qëllim informimin e saktë dhe të plotë të opinionit të gjerë. Rrjedhimisht, me qëllim të përbushjes së këtij synimi, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminuar asnjë grup shoqëror, konkretisht mbi bazën e aftësisë së kufizuar, është më se e nevojshme që kategorisë së personave me aftësi të kufizuar në dëgjim t'i sigurohet mundësia për t'u informuar vazhdimesh përgjatë debateve të cilat zhvillohen në kuadër të fushatës zgjedhore, në mënyrë që të drejtën e tyre për të votuar ta ushtrojnë bazuar në gjykimin e tyre të pavarur.
2. Avokati i Popullit konsideron se **të gjitha televizionet**, të cilat gjatë kohës së fushatës parazgjedhore zhvillojnë debate me kandidatë për përfaqësues të popullit (kandidatët për kryeministër dhe për deputetë), duhet të angazhojnë interpretë të certifikuar për Gjuhën e Shenjave, ashtu që edhe qytetarët me aftësi të kufizuar në dëgjim ta kenë mundësinë e informimit dhe vlerësimit të përfaqësuesve të tyre potencialë në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. KPM-ja, bazuar në mandatin dhe kompetencat ligjore që ka, duhet të ndërmarrë veprime të cilat ndikojnë dhe inkurajojnë ofruesit e shërbimeve audiovizuale në përshtatjen ndaj diversitetit dhe luftimin e diskriminimit, duke siguruar që shërbimet e tyre, në mënyrë graduale, të bëhen plotësisht të qasshme për grupet e ndryshme të personave me aftësi të kufizuar.



Me nnderime,
Hilmij Jashari
Avokat i Popullit